

E. KOLIQI – Kumbulla përtej murit

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

Koliqi ka shkruar poezi, tregime, proza poetike e roman.

Si do të mbetet ai në letërsinë shqipe: poet, tregimtar, romancier?

Duke pasur parasysh periudhën kur shkruan, analizoni rëndësinë e Koliqit në letërsinë shqipe.

Në ç'rrymë letrare mund ta kuadrojmë Koliqin? Argumentoni përgjigjen tuaj.

Cila është teknika e vështrimit nga brenda jashtë, e përdorur nga Koliqi në tregimet e tij?

Në ç'mënyrë shërbejnë personazhet si mjet lidhës ndërmjet tregimeve?

Cili është momenti për të cilin flet ky tregim?

-shënime-

Cila është arsyeja që tregimit i paraprin një mungesë e heroit kryesor?

Si mund ta shpjegojmë faktin që gjithçka ndodh *kah mbarimi i zhegut, nësa të tjerët flejshin ende?*
Ç'janë të tjerët në rrafshin simbolik dhe ç'rol luan zhegu/të nxehtë?

Çfarë shënojnë skutat e kopshtit ku strukeshin kujtimet e ëmbla të fëmijërisë?

Si realizohet kuptimi simbolik i kopshtit?

Për të gjetur shtresat kuptimore të fjalës kopsht, krahasoni dy kopshtet (të nënës së dajës dhe të plakës).

Ç'ndryshim ka kopshti nga pylli? (kopshti i nënës së dajës dhe kopshti i plakës si pyll)

-shënime-

...hali prrallash shpalisë nën këmbët e një princeshe të zhdukun.

Cila është kjo princeshë e zhdukur?

Vetëdija dhe nënvetëdija përfytyrohen rëndom si të shtresëzuara njëra brenda tjetrës.

Si e ka realizuar artistikisht Koliqi këtë kalim?

Cili është kuptimi figurativ i murit dhe kumbullës?

Pse muri dhe kumbulla nuk shënojnë konservatorizmin e shoqërisë së kohës (ose shoqërisë shqiptare) përkundër idesë së lirisë së individit?

Gjeni dhe analizoni tiparet, që i japin murit shtresëzimet kuptimore simbolike.

Analizoni nëntekstin e simbolit dhe antitezës që krijohet midis *murit* (pengesa, skrupujt moralë, morma sociale) dhe *jaseminit* (përçafimi, akti dashuror, kureshtja seksuale, zotërimi) në të dyja kohët e rrëfimit.

-shënime-

Çfarë simbolizon kumbulla?

*Harroi moshën, humbi njohurin e kohës e të vendit...
dhe u gjet maje murit, midis degëve të kumbullës.*

Pse duhet të harrojë moshën për të kryer këtë veprim?

Atëherë ç'është muri, çfarë simbolizon?

Marri! S'jam ma i vogël si atëherë! Dikur do sende mund i bajshëm... Tashti ash marre me më pa kush.

Pse dikur mund t'i bënte? Çfarë nuk e ndalonte?

Pse tani është marre? Pse me e pa kush?

Pse kur preku kumbullat i rrëshqiti një të dridhun andjeje në trup si të prekte mishin e njomë të një krijatyre nxehtësisht e gjatë mot andrrue e pritë?

Çfarë kërkonte në kopshtin e plakës Leci?

Është vjedhës në kuptimin simbolik?

Shpjegoni faktin që Leci kërkon të ikë me vrap, kur dëgjon zërin e gruas në kopsht.

-shënime-

Gjeni përse figurën e plakës e kemi të parë në dy plane.

Pse plaka gëzohet kur sheh Lecin t'i hyjë në kopsht dhe bën të kundërtën e asaj që duhej të bënte?

...mbaj mend se më hijshë në kopësht... më janë lecue vjett në shtat kah të shifshë tue ecë hajnisht si dikur...

Pse plaka i thotë Lecit për reçelin: *“Asht i bamë me kumbullat e tuja”*?

Vini re tiparet e përbashkëta që kanë në këtë tregim fjalët: *amë, amnija, amtija, amsimi*. Me se mund ta shpjegojmë përdorimin e tyre?

Shkruani një ese interpretuese:

Interpretoni zgjidhjen figurative të tregimit: Leci do të provojë kumbullat në pemë, por i japin të hajë reçelin e bërë me to (kumbullat e përpunuara: produkt i natyrës plus eksperiencën jetësore dhe rregullat e nxjerra prej saj).